

VENDIM
Nr. 18/2012

PËR NJOFTIMIN E KRIJIMIT TË VAKANCËS, PËR SHKAK TË DORËHEQJES NGA MANDATI I DEPUTETIT GJON HILL BARDHI DHE PLOTËSIMIN E DETYRIMEVE DHE TË PROCEDURËS LIGJORE NGA KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN ZGJEDHORE PËR KANDIDATËT E LISTAVE SHUMEMËRORE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, PAS PËRFUNDIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, të nenit 164 pika 1 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i cili mbështetet në premisat e asnjansisë në çështjet e debatit të ngritur rreth kësaj çështjeje,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të njoftojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend, për shkak të dorëheqjes nga mandati i deputetit Gjon Hill Bardhi.

II. Rasti i zëvendësimit të këtij mandati, diskutimet juridike të zhvilluara për të dhe kompleksiteti i situatës së veçantë juridike të çështjes të merren në shqyrtim nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 141, datë 17.11.2011, me qëllim saktësimin dhe plotësimin e detyrimeve dhe të procedurës ligjore që duhet të ndiqet për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore, pas përfundimit të zgjedhjeve për Kuvendin.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 12.4.2012